


Treguesit demografikë

Tremujori II – 2025

Tiranë, më 12 Gusht 2025: Shtesa natyrore e popullsisë për tremujorin e dytë 2025 rezultoi pozitive, duke regjistruar 48 lindje më shumë sesa vdekje, ku:

- numri i lindjeve për tremujorin e dytë 2025 është 4.982, duke shënuar një rënie me 7,4 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2024;
- numri i vdekjeve për tremujorin e dytë 2025 është 4.934, duke shënuar një rënie prej 3,7 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2024.

Fig. 1: Shtesa natyrore e popullsisë




* Të dhëna paraprake

Në tremujorin e dytë të vitit 2025, katër qarqe të vendit regjistrojnë shtesë natyrore pozitive të popullsisë, ndërsa në tetë qarqet e tjera, shtesa natyrore e popullsisë është negative.

Në tremujorin e dytë 2025, qarku me shtesën natyrore më të lartë është Tirana, me 691 lindje më shumë se vdekje, ndërsa qarku me shtesën natyrore më të ulët është Korça, me 226 vdekje më shumë se lindje.

Fig. 2: Lindjet, vdekjet dhe shtesa natyrore sipas qarqeve, T2 – 2025*



* Të dhëna paraprake

Lindjet

Në tremujorin e dytë të vitit 2025, një qark i vendit shënoi rritje të numrit të lindjeve, ndërsa njëmbëdhjetë qarqe të tjera shënuan rënie, në krahasim me tremujorin e dytë të vitit 2024.

Qarku me numrin më të lartë të lindjeve ishte Tirana me 1.982 lindje, ndërsa qarku me numrin më të ulët Gjirokastra me 74 lindje.

Qarku i Kukësit shënoi rritjen më madhe në përqindje të lindjeve, gjatë tremujorit të dytë të vitit 2025, krahasuar me tremujorin e dytë 2024, përkatësisht me 6,5 %, ndërsa qarku i Korçës shënoi rënien më madhe me 26,0 %.

Tab. 1: Lindjet sipas qarqeve

Nr.	Qarku	2024-2	2024-3	2024-4	2025 - 1*	2025 - 2*
	Shqipëria	5.380	6.483	6.019	4.662	4.982
1	Berat	198	212	212	169	167
2	Dibër	258	310	283	202	250
3	Durrës	600	738	676	541	528
4	Elbasan	461	568	533	385	434
5	Fier	443	567	494	381	393
6	Gjirokastrë	75	90	91	76	74
7	Korçë	311	314	258	254	230
8	Kukës	153	198	177	138	163
9	Lezhë	228	275	286	208	216
10	Shkodër	321	440	405	299	304
11	Tiranë	2.068	2.460	2.346	1.750	1.982
12	Vlorë	264	311	258	227	212
	**Të panjohur	0	0	0	32	29

* Të dhëna paraprake

** Kategoria "Të panjohur" nënkupton/numrin e lindjeve të gjalla, për të cilat informacioni i qarkut ku është regjistruar lindja mungon.¹**Vdekjet**

Qarku me numrin më të ulët të vdekjeve ishte Kukësi me 119 vdekje, ndërsa qarku me numrin më të lartë Tirana me 1.291 vdekje. Rënien më të lartë në përqindje të vdekjeve gjatë tremujorit të dytë 2025, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024, e zë qarku Gjirokastrë me 19,1 %, ndërsa rritje është shënuar në qarkun Berat me 4,6 %.

Tab. 2: Vdekjet sipas qarqeve

Nr.	Qarku	2024-2	2024-3	2024-4	2025 - 1*	2025 - 2*
	Shqipëria	5.121	5.728	5.366	5.545	4.934
1	Berat	239	301	324	311	250
2	Dibër	204	200	218	195	201
3	Durrës	465	546	437	528	417
4	Elbasan	513	578	514	538	478
5	Fier	614	747	589	612	572
6	Gjirokastrë	183	176	180	160	148
7	Korçë	505	476	497	531	456
8	Kukës	118	142	121	123	119
9	Lezhë	231	235	254	266	227
10	Shkodër	411	463	422	465	409
11	Tiranë	1.279	1.404	1.407	1.423	1.291
12	Vlorë	359	460	403	385	344
	**Të panjohur	0	0	0	8	22

* Të dhëna paraprake

** Kategoria "Të panjohur" nënkupton/ numrin e vdekjeve, për të cilat informacioni i qarkut ku është regjistruar vdekja mungon.

Për më shumë informacion dhe për të parë tabelat e detajuara, vizitoni bazën e të dhënave në faqen zyrtare të INSTAT: [Treguesit demografikë](https://www.instat.gov.al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/lindjet-vdekjet-dhe-martestat/#tab4)

¹ Shiko metodologjinë në linkun në vijim: <https://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/lindjet-vdekjet-dhe-martestat/#tab4>

Metodologjia

Të dhënat tremujore për lindjet dhe vdekjet, në nivel kombëtar dhe qarku përbëjnë një hallkë të rëndësishme të demografisë së vendit. Ato paraqesin të dhëna mbi ndryshimet në popullsi, të cilat kanë impakt në jetën ekonomike dhe sociale të vendit. Këto të dhëna publikohen mbështetur në Programin e Statistikave Zyrtare 2022-2026.

Lindjet

Të dhënat e lindjeve:

Të dhënat e lindjeve sipas karakteristikave bazë demografike sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila dërgon në INSTAT vetëm numrin e lindjeve të banuesve në Shqipëri. Konsiderohen të gjitha lindjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh lindjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve), edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile, pranë ish-vendbanimeve të tyre.

Regjistrimet e vona të lindjeve

Kryhet një rregullim i vogël i numrit të lindjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha lindjet e ndodhura në periudhën referencë.

Numri i lindjeve të regjistruara vonë nga viti i mëparshëm janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të lindjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

Vdekjet

Të dhënat e vdekjeve

Të dhënat e vdekjeve, sipas karakteristikave bazë demografike sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila dërgon në INSTAT vetëm numrin e vdekjeve të banuesve në Shqipëri. Konsiderohen të gjitha vdekjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh vdekjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve), edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile pranë ish-vendbanimeve të tyre.

Regjistrimet e vona të vdekjeve

Bëjmë një rregullim të vogël të numrit të vdekjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha vdekjet e ndodhura në periudhën referencë.

Numri i vdekjeve të regjistruara vonë nga viti i mëparshëm janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të vdekjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

Përkufizime:

Shtesa natyrore e popullsisë: Shpreh rritjen/rënien e popullsisë, si rezultat i proceseve biologjike (lindjeve dhe vdekjeve) të saj, gjatë një periudhe kohe.

Ky tregues shprehet si diferencë ndërmjet lindjeve dhe vdekjeve.

Lindje e gjallë: Lindjet e fëmijëve që shfaqën shenja jete.

Vdekje: Nënkupton zhdukjen e përhershme të të gjitha shenjave të jetës, në çdo kohë pasi ka ndodhur një lindje e gjallë (ndërprerjen e funksioneve vitale, pa aftësinë e ringjalljes).